Pa. nr. 08-143

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga LARS LARSEN GROUP A/S, me seli të regjistruar në Randersvej 2C, 8600 Silkeborg, Danimarkë, nëpërmjet Shoqërisë së Avokatëve Qoku dhe Partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 22.10.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi, me të cilin LARS LARSEN GROUP A/S, me seli të regjistruar në Randersvej 2C, 8600 Silkeborg, Danimarkë, do të fitojë kontroll të pavarur mbi franshizën JYSK në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili është në pronësi dhe administrohet nga SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup, me seli të regjistruar në bul. „8 Shtatori“ nr. 19A, Shkup – Karposh, Shkup, edhe pse bie në fushëveprimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve në treg, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës**.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim që të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6.000,00 denarësh dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarësh, sipas tarifës nr. 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të hyrave dhe programi 72231300.

3. Padia për inicimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), më datë 06.10.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga LARS LARSEN GROUP A/S, me seli të regjistruar në Randersvej 2C, 8600 Silkeborg, Danimarkë, me të cilin LARS LARSEN GROUP A/S do të fitojë kontroll të pavarur mbi franshizën JYSK në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili është në pronësi dhe administrohet nga SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup, me seli të regjistruar në bul. „8 Shtatori“ nr. 19A, Shkup – Karposh, Shkup.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për Përqendrim dhe shtojcave të tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

LARS LARSEN GROUP A/S është shoqëria udhëheqëse e JYSK A/S, shoqëri holding e markës JYSK, e cila është një tregtar ndërkombëtar me pakicë i produkteve për rregullimin dhe pajisjen e shtëpisë. Krahas veprimtarisë së saj kryesore të shitjes me pakicë të JYSK-ut, grupi më i gjerë LARS LARSEN GROUP ka pjesëmarrje edhe në një sërë veprimtarish të tjera të shitjes me pakicë dhe investuese, duke përfshirë edhe marka të mobilieve si Bolia, ILVA, Sofacompany dhe Actona Group, si dhe investime financiare dhe investime në patundshmëri.

Veprimtaria kryesore afariste e JYSK-ut është shitja me pakicë e produkteve të arritshme për gjumë dhe banim, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, dyshekë, jorganë dhe jastëkë, shtroja dhe çarçafë, mobilie për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, artikuj shtëpiakë, tekstile për shtëpi, produkte për dekorimin e dritareve dhe produkte për banjë. JYSK operon përmes një modeli të integruar omnichannel (shumëkanalësh), i cili ndërthur më shumë se 3.500 dyqane fizike dhe dyqane online në 50 shtete, të mbështetura nga një rrjet i gjerë logjistik, që përfshin 10 qendra shpërndarjeje dhe 21 qendra për mbështetjen e klientëve, si dhe plotësohet me ofertë për klientët afaristë për furnizimin e hoteleve, organizatave dhe kompanive të të gjitha madhësive.

LARS LARSEN GROUP A/S në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një shoqëri të regjistruar të varur – Shoqërinë për Tregti dhe Shërbime 3B BIDCO SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. „Maksim Gorski“ nr. 13 B/C, lagjja/ndërtesa 1, hyrja 1-4/4, Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare të regjistruar 47.550 – Tregti me pakicë e mobilieve, pajisjeve për ndriçim, enëve dhe pajisjeve të kuzhinës dhe produkteve të tjera për amvisëri. Kjo shoqëri është themeluar së fundmi si shoqëri me qëllim të posaçëm, e regjistruar konkretisht për qëllimet e marrjes në pronësi dhe administrimit të veprimtarisë afariste në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Aktualisht, LARS LARSEN GROUP A/S nuk administron drejtpërdrejt asnjë dyqan në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Koncepti i shitjes me pakicë i JYSK-ut zbatohet në nivel lokal nga një partner i pavarur i franshizës, i cili aktualisht administron gjashtë dyqane të franshizës JYSK (ndërsa së shpejti pritet të hapet edhe dyqani i shtatë) në vend, në bazë të një marrëveshjeje për franshizë të lidhur ndërmjet SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup dhe JYSK A/S. Të hyrat e LARS LARSEN GROUP në Republikën e Maqedonisë së Veriut realizohen ekskluzivisht përmes shitjes me shumicë ndaj partnerit të pavarur të franshizës SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup.

SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup është operatori ekskluziv i franshizës së markës JYSK në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Marrësi i franshizës ushtron veprimtari të shitjes me pakicë të produkteve për amvisëri dhe stil jetese, duke ofruar një gamë të gjerë mobiliesh, dyshekësh, artikujsh dekorativë për shtëpi, tekstilesh, mobiliesh për kopsht dhe produkteve të tjera për shtëpi.

SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup administron një rrjet dyqanesh me pakicë në të gjithë Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe u ofron shërbime konsumatorëve përmes një koncepti modern të dyqaneve, në përputhje me standardet ndërkombëtare të JYSK-ut dhe marrëveshjen e franshizës me JYSK-un. Mallrat sigurohen kryesisht përmes zinxhirit të furnizimit dhe rrjetit të shpërndarjes së JYSK-ut, duke garantuar cilësi dhe disponueshmëri të vazhdueshme të produkteve. Krahas shitjes me pakicë, SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup kryen edhe aktivitete që lidhen me administrimin e stoqeve, logjistikën,

marketingun, mbështetjen e klientëve dhe aktivitetet në dyqane, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë afariste të shitjes me pakicë.

Veprimtaria afariste objekt i përqendrimit përfshin të gjitha pajisjet, mjetet materiale, kontratat dhe punonjësit e nevojshëm që SKANDINAVIAN LIVING SHPKNJP eksport-import Shkup të mund të ushtrojë veprimtarinë afariste të franshizës JYSK në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e dispozitave të Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe të nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, si rregull, do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, ndonëse bie në fushëveprimin e Ligjit, është në përputhje me të, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve në treg.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për inicimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ